

	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena <b>"UKSHIN HOTI"</b>
Pranuar me dit.	15.06.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-257



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**Universitetit “Ukshin Hoti” - Prizren**

dhe

**Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup**

Bazuar në interesin e përbashkët në ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e gjuhës, letërsisë, kulturës, traditës dhe vlerave tona të përbashkëta në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren dhe në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, si dhe nisur nga qëllimi i përbashkët për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve publike:

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, si institucion publik shkencor i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2007, adresa: “Blv. Ilinden 99, Shkup 1000, Maqedonia e Veriut, adresa elektronike: [www.itsh.edu.mk](http://www.itsh.edu.mk), i përfaqësuar nga drejtori prof. dr. Skender Asani,

dhe

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, si universitet publik i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 2009, adresa: “Ruga e Shkronjave” nr. 1; 20000 Prizren; Kosovë, adresa elektronike: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com), i përfaqësuar nga rektori prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj,

## dakordohen

**për të nënshkruar këtë marrëveshje të bashkëpunimit, të bazuar në pikat si në vijim:**

1. Organizimi i takimeve të përbashkëta arsimore, kulturore dhe shkencore;
2. Ligjérata të përbashkëta ofruar nga specialistë të gjuhës, letërsisë, kulturës, historisë, arkeologjisë dhe traditës kombëtare;
3. Projekte studimore – me interes të përbashkët për gjuhën shqipe dhe kulturën tonë shqiptare, që ndërlidhen me të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e të dy qendrave tona: Shkupin e Prizrenin;
4. Vizita të ndërsjellta të stafit akademik dhe të studentëve;
5. Shkëmbim të botimeve në mes të dy institucioneve;
6. Promovim librash e vlerash të përbashkëta;
7. Aktivitete tjera akademike, shkencore e kulturore me interes të ndërsjellë.

I. Zbatimi i aktiviteteve konkrete që dalin nga fryma e kësaj marrëveshjeje ndërmjet Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren dhe Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, do të bëhet në koordinim të plotë mes dy subjekteve.

II. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bëhet me vullnet të plotë dhe nuk nënkupton asnjë detyrim finansiar për palët nënshkruese.

III. Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e nënshkrimit. Pas përfundimit të datës kjo marrëveshje mund të vazhdohet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim apo edhe të ndërpritet.

IV. Kjo marrëveshje mund të prishet edhe para skadimit të afatit, nëse njëra palë nuk i plotëson kërkesat e marrëveshjes.


V. Kjo marrëveshje gjen zbatim me nënshkrimin nga përfaqësuesit kompetent ligjorë të të dy institucioneve.

VI. Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Prizren, më 15.06.2022

Drejtore i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore  
e Kulturore të Shqiptarëve Shkup

Prof. dr. Skender Asani.



Rektor i Universitetit "Ukshin Hoti"  
Prizren

Prof. asoc. dr. Samedin Krrabaj

